



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	27-06-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHKOC	4941/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.768/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.768/2023, të datës 23.05.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë në rr. Prishtinë, kundër Institucionit Thesari i Kosovës, në çështjen administrative-juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 27.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.768/2023 e datës 23.05.2023, e parashtruar nga ankuesi

II.Shfuqizohet Vendimi Nr.508 i datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Udhëheqës për Menaxhimin e PPB-së" në Drejtorin Qendrorë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 23.05.2023, përmes Emailit ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babës). Ndërsa përmes Vendimit me nr.508 të datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës e ka aprovuar kërkesën e ankuesit për një pagë shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes(Babës).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi me datë 23.05.2023 ka marr përgjigjeje nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës se kërkesa e ankuesit është proceduar në Thesarin e Kosovës mirëpo ky Institucion nuk e ka ekzekutuar Vendimin me nr.508 i datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me arsyetimin se pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri Nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë kompensim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit të datës 23.05.2023 i cili organ kishte njoftuar ankuesin se Vendimi me Nr.508 i datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës nuk është zbatuar nga Thesari i Kosovës me arsye se Ligji Nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë kompensim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes , më datë 23.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4382/2023 të regjistruar me numër A.nr.768/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kërkuar që të detyrohet Thesari i Kosovës që të zbatoj vendimin me nr.508 të datës 24.04.2023 të nxjerrë nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 31.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura, ndërsa nuk është kërkuar ndonjë përgjigje në ankesë nga Thesari i Kosovës për faktin se në shkresat e lëndës kemi përgjigjen nga ky institucion në lidhje me këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj anekese ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 4382/2023 të datës 23.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë e lindjes e I.N; Deklaratë e bashkësisë familjare e ankuesit; Vërtetim për Vdekjen nga QMU i datës 04.04.2023 e I.N; Certifikatë e vdekjes e I.N; Vendimi me Nr.508 i datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Emailin e datës 23.05.2023; Emailin e datës 23.05.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i ankuesit; Emailin e datës 15.04.2023 nga Thesari i Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi me datë 23.05.2023, përmes Emailit ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babës). Ndërsa si dëshmi ankuesi ka ofruar certifikatën e lindjes për të ndjerin (babën) të datës 05.04.2023, Ekstraktin e lindjes për të ndjerin (babën) të datës 05/04/2023, certifikatën e vdekjes me nr.V10586109 të datës 18.04.2023 me të cilin dëshmohet se babai i ka vdekur me datë 27.03.2023 dhe

Deklaratën e Bashkësisë Familjare të datës 20.04.2023, ndërsa përmes Vendimit me Nr.508 të datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës ju ka lejuar një pagë shtesë për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (babës) përkundër që nuk i është referuar ndonjë kërkesë të ankuesit sa i përket realizimit të kësaj të drejte ndërsa kërkesa përmes emailit është e datës 23.05.2023, ndërsa vendimi është i datës 24.04.2023, por se Thesari i Kosovës e ka njoftuar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës se nuk mund të procedohet pagesa për një pagë shtesë për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes për shkak të ndryshimit të legjislacionit përkatës që rregullon këtë çështje nga se Ligji i ri Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtua pretendimin ankimor të ankuesit thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë në nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: *"1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji"*. Andaj me krijimin e këtyre rrethanave të reja ligjore, kolegji i këshillit konstaton se një e drejtë që ishte e paraparë me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nëpunësve Civil, përveç që ky ligj dhe rregullore janë të shfuqizuara, tashmë me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parashihet një kompensim i kësaj natyre me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, dhe referuar kësaj baze të re ligjore, Thesari i Kosovës me të drejtë dhe bazuar në legjislacionin e potencuar si më lartë ka refuzuar kërkesën e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës për zbatimin e vendimit me Nr.508 të datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ndërlidhur me dispozitat e përcaktuara si më lartë dhe nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative kolegji i këshillit konstaton se vendimi Nr.508 i datës 24.04.2023 përmes së cilit ankuesit i është lejuar kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (Babës), është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik përkatësisht nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji dhe poashtu përveç Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës Nr.08/L-131 referenca ligjore me rastin e nxjerrës së këtij vendimi është Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nëpunësve Civil të cilat tashmë si Ligji Nr. 03/L-147 poashtu edhe Rregullorja Nr.33/2012 janë shfuqizuar tërësisht përmes Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik respektivisht nenit 45 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, andaj edhe mbi këto arsye i njëjti vendim nuk mund të ketë asnjë fuqi ligjore, prandaj në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në nuungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"*, vendimi me Nr.508 i datës 24.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është shfuqizuar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.



Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.768/2023, datë 27/06/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Thesarit të Kosovës.
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

